



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA Vlorë
Këshilli i Bashkisë

Nr 2667 Prot

Vlorë, më 20.02 2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit të bashkisë, datë 26 shkurt 2024.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË Vlorë

Për dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË Vlorë**

PREFEKTIT TË QARKUT Vlorë

Ju njoftoj se, **ditën e hënë, datë 26.02.2024, ora 10:00**, në pallatin e kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas pikave ;

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, datë 29.01.2024.
2. Shprehje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 1- 8, datë 29.01.2024,

Do të vazhdojmë me këtë Rend Dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin janar 2024”
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin janar 2024”.
3. Projektvendim “Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella sociale ekonomike që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për një periudhë 12 mujore me të ardhurat e bashkisë”
4. Projektvendim “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”

5. Projektvendim “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinansim, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për, “Programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
6. Projektvendim “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për “Programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
7. Projektvendim “Për krijimin e Shoqërisë “Markata e peshkut –Vlorë” SH.A, si person juridik , në pronësi të Bashkisë Vlorë dhe miratimit të Statutit “
8. Projektvendim “Për dhënien e dakortësisë në vijimin e procedurave , të heqjes së fondit kullor publik(për sipërfaqen prej 0,97 ha, në ekonominë kullimore Shashicë-Gumenicë, ngastrat nr 14 dhe 15), aktiviteti i prodhimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror(karrierë), nga Shoqëria “VAMEL”Sh.p.k
9. Të ndryshme.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e enjte, datë 22.02.2024, ora 10.00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e enjte, datë 22.02.2024, ora 11.00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e enjte, datë 22.02.2024, ora 12.00.

Komisioni i bujqësisë, pyjeve dhe menaxhimit të ujrave, do të mbledhet ditën e enjte, datë 22.02.2024, ora 13.00.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri

